



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.837/8 prot.

Tiranë, më 13.6.2023

**VENDIM**

**Nr. 27, datë 13.6.2023**

**PËR KONTROLLUESIN “ELTON ZHULEKU” PERSON FIZIK**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Elton Zhuleku” Person Fizik (në vijim, “Kontrolluesi ose SoftExpres”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 69, datë 10.05.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit nga subjektet e të dhënave E. I dhe Xh. B, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L41316032F, i cili ushtron aktivitetin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, të tilla si programe kompjuterike, zhvillimin e Software, konsulencë IT dhe shërbime të tjera IT.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “vizitorë”, “punonjës”, “klientë”, “kandidatë për punë”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur ankesa e qytetarëve E.I dhe Xh.B., të cilët pretendojnë se Kontrolluesi kryen, nëpërmjet kamerave të survejimit, përpunim të të dhënave personale në kundërshtim me ligjin, pasi kamerat e survejimit mbikëqyrin ambientet e brendshme (zyra dhe korridore) ku në fokus janë punonjësit.

2. Grupi i kontrollit gjatë hetimit të ushtruar në ambientet e “SoftExpres” konstatoi se kamerat e survejimit janë aktive dhe kryejnë monitorimin e ambienteve të brendshme (zyra dhe korridori). Njësia qendrore e mbikëqyrjes të sistemit CCTV është vendosur në ambientet e Kontrolluesit. Konstatohet se, Kontrolluesi ka të instaluar sistemin e survejimit CCTV, të përbërë nga gjashtë kamera, i cili kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme, në kundërshtim me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 11, datë 08/09/2011, të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Gjithashtu, është konstatuar se Kontrolluesi nuk informon subjektet mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, nëpërmjet sistemit të video-surveimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video/audio-surveimit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “imazhe”, “video” dhe “zëri/audio”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesit.

Gjithashtu, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

3. Kontrolluesi nuk ka vendosur “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare <https://www.softexpres.com>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave, të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale. Subjektet e të dhënave personale nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, si dhe mbi personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezulton se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre, sipas Ligjit.

5. Kontrolluesi nuk disponon “*Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregulloreje specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi dhe përfaqësuesi i tij, u paraqitën në seancën dëgjimore, ku parashtruan qëndrimin me shkrim, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit.

Me shkresën nr. 837/6 prot., datë 21.06.2023, Kontrolluesi parashtrori argumentet e përmbledhura, si më poshtë:

- *Subjekti ushtron aktivitet në ambientet e marra me qira sipas kontratës së qirasë nr.2308 rep, datë 14.08.2020 me qiradhënës z. E. R. Në momentin e marrjes së ambientit me qira, sistemi i kamerave dhe pajisjeve mbështetëse ka qenë i instaluar nga ana e pronarit të ambientit, me qëllim ruajtjen e pronës nga dëmtimet e ndryshme që mund t'i shkaktohen nga qiramarrësit dhe nga keqbërës të ndryshëm në kohën kur nuk është e dhënë me qira. Subjekti e ka përdorur sistemin e kamerave shumë rrallë për shkak të defekteve teknike të herëpashershme.. Në lidhje me punonjësit ata bëhen me dije që në momentin para fillimit të marrëdhënieve të punës dhe asnjë deri më tani nuk ka pasur kundërshti, përndryshe, nëse do të kishin problem faktin e monitorimit, atëherë atyre nuk do t'i mundësohej lidhja e kontratës së punës. Për këtë qëllim, punonjësit kanë nënshkruar edhe një deklaratë personale në lidhje me dijeninë dhe dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave.*

Lidhur më këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron, pasi pavarësisht faktit që sistemi i kamerave është instaluar nga pronari i ambienteve, është konstatuar që efektivisht, Kontrolluesi, sistemin e survejimit CCTV, e përdor si aset në funksion të veprimtarisë së tij. Sipas konstatimeve në vend, është dokumentuar se, Kontrolluesi vetëm apo së bashku me të tjerë, ka akses në sistemin e survejimit, në të cilin ruhen imazhe/video të kamerave të regjistrimit. Në pajisjen e regjistrimit të sistemit të survejimit, gjenden të ruajtura plane të kamerave, që nga data 14.04.2023 deri në momentin e verifikimit nga grupi i kontrollit.

Udhëzimi nr. 11 e përcakton shumë qartë, në pikën 10.2 të tij, se kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës.

- *Në lidhje me “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, dhe sigurinë e të dhënave personale”, ajo është dërguar me email nga ana e subjektit pas kërkesës së bërë nga grupi i kontrollit.*

Lidhur me këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron, pasi rregullorja e vendosur në dispozicion të grupit të kontrollit, është një rregullore e përgjithshme e prezencës në punë dhe nuk është një rregullore specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, dhe sigurinë e të dhënave personale”.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*

- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara dhe pasojat janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 39 pika 1, germat “a”, “b”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

### **V E N D O S A:**

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit;
- 3- Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, për të gjitha proceset përpunuese, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
- 4- Kontrolluesi të ndalojë monitorimin e punonjësve në vendin e punës përmes sistemit të survejimit CCTV, si dhe të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat “video/audio” të mbledhura për subjektet e të dhënave “punonjës”, të cilat janë përpunuar, në kundërshtim me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për shkatërrimin;
- 5- Kontrolluesi, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, në zbatim të detyrimeve të nenit 18 të Ligjit;
- 6- Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 7- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke

parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;

- 8- Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:
- i. menjëherë, detyrimet e përcaktuara në pikën 4 më sipër;
  - ii. vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 3, 5 dhe 6 më sipër;
  - iii. brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

- 9- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
- 10- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
- 11- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 13.6.2023.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**